



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.nr.102/2023

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fejzullah Rexhepi, kryetar i kolegjit, Nenad Lazic dhe Zenel Leku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit: A. M. nga S., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shpëtim Sadiku avokat nga L., kundër të paditurës L. K. I. A. J.S.C, “A. J.” me seli në ..., të cilën e përfaqëson Shkelzen Sopjani avokat në Fushë Kosovë dhe Leonora Fejzullahu zyrtare ligjore me autorizim, për anulimin e vendimit, kthim në punë dhe kompensimin e pagave, duke vendosur lidhur me revizionin e paditësit të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.9165/2021, të datës 15.12.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 29.03.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet i pabazuar revizioni i paditësit: A. M. nga S., i paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.9165/2021, të datës 15.12.2022.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan C.nr.464/20 i datës 27.05.2021, është vendosur: që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit A. M. nga S., si e bazuar dhe anulohet vendimi i të paditurës për mos ripërtëritje të kontratës së punës i datës 31.01.2020 për paditësin dhe detyrohet e paditura “L.” K. I. A. J.S.C. me seli në V., që në afatin prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjyqimit, paditësin ta kthejë në punë dhe detyra të punës pastrues të terminalit dhe ndërtesave (Terminal building and cleaning), si dhe brenda të njëjtit afat paditësit t’ia kompensoj dëmin material për periudhën nga data

01.02.2020 e deri më datën 18.11.2020 në emër të pagave neto në shumë prej 2,384.50€ me kamatë ligjore prej 8% në vit duke filluar nga data e nxjerrjes së ekspertizës financiare të datës 18.11.2020 e deri tek pagesa definitive. Si dhe në të ardhmen për çdo muaj në emër të pagës bruto shumë prej 303.20€ nga data 18.11.2020 e deri në kthimin e paditësit në punë dhe detyra të punës si më lartë. Ndërsa në emër të kontributit në llogarinë e Trustit Pensional ..., në shumë prej 129.74€, në emër të tatimit në burim në llogari të ATK-së ..., shumë prej 81.95€, si dhe në emër të kamatës së arritshme shumë prej 69.61€, të gjitha këto në afatin prej 7 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim. Detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1,081.60€ në afat prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur sipas ankesës së palës së paditur me aktgjykimin Ac.nr.9165/2021, të datës 15.12.2022, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e të paditurës L. K. I. A. J.S.C, "A. J." me seli në ..., duke e ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.464/20 të datës 27.05.2021, ashtu që ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit A. M. nga S., me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurës për mos ripërtëritje të kontratës së punës i datës 31.01.2020, për paditësin dhe të detyrohet e paditura L. K. I. A. J.S.C, "A. J." me seli në ..., që në afatin prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit, paditësin ta kthejë në punë dhe detyra të punës pastrues të terminalit dhe ndërtesave (Terminal building and cleaning), si dhe brenda të njëjtit afat, paditësit t'ia kompensoj dëmin material për periudhën nga data 01.02.2020, e deri më datën 18.11.2020, në emër të pagave neto në shumë prej 2,384.50€, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data e nxjerrjes së ekspertizës financiare të datës 18.11.2020, e deri tek pagesa definitive. Si dhe në të ardhmen për çdo muaj në emër të pagës bruto shumë prej 303.20€ nga data 18.11.2020, e deri në kthimin e paditësit në punë dhe detyra të punës si më lartë. Ndërsa në emër të kontributit në llogarinë e Trustit Pensional ..., në shumë prej 129.74€, në emër të tatimit në burim në llogari të ATK-së ..., shumë prej 81.95€, si dhe në emër të kamatës së arritshme shumë prej 69.61€, të gjitha këto në afatin prej 7 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim, si dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1,081.60€ në afat prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion paditësi, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme aktgjykimin e gjykatës së shkallës së të dytë ta ndryshojë dhe të mbetet në fuqi aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

E paditura ka paraqitur përgjigje në revizionin e paditësit, me propozim që revizioni i paditësit të refuzohet në tërësi i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, më datë 13.03.2020, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për anulimin e vendimit për mos vazhdimin e kontratës së punës, kthimin në punë dhe kompensimin e të ardhurave personale duke kërkuar më saktësisht si në parashtrësën për precizimin e padisë të datës 20.04.2021. Në padi paditësit ka theksuar se me të paditurën ka lidhur kontratë pune në kohë të caktuar për shumë vite dhe mban pozitën Me tutje ka shtuar se paditësi më datë 31.01.2020 ka pranuar nga ana e të paditurës vendimin për mosripërtirjen e kontratës së punës duke e njoftuar se më datën 31.01.2020 përfundon kontrata e punës, pa e arsyetuar largimin. Paditësi më datë 07.02.2020, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë ndaj vendimit në fjalë dhe e paditura me përgjigjen e datës 22.02.2020 ka refuzuar ankesën e paditësit të datës 07.02.2020. Gjithashtu ka theksuar se e paditura gabimisht ka zbatuar nenin 72 par.3 të Ligjit të punës si në vendimin e atakuar dhe ligjor. Në arsyetimin e vendimit të paditurës është thirrur në dispozitën e nenit 72 par.2 të Ligjit të Punës e cila dispozitë decidivisht ka paraparë se "Punëdhënësi është i obliguar të bëjë pagesën e pagës dhe të ardhurave tjera, deri në ditën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës", ndërsa vendimi i të paditurës është emërtuar mosripërtirje e kontratës së punës por realisht e paditura e ka ndërprerë kontratën e punës. Duke iu referuar dispozitës së nenit 70 par.1 pika 1.1 të Ligjit të Punës ka paraparë "Punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur 1.1 ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative". Në parashtrësën për precizimin e kërkesëpadisë të dorëzuar në gjykatë

më datë 20.04.2021, i ka propozuar gjykatës që të aprovoi kërkesëpadinë e precizuar të paditësit sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë.

E paditura e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, për mos ripërtirjen e kontratës së punës dhe shpërblimit të dëmit për shkak të mosrealizimit të të ardhurave personale dhe kthimin në punë, me arsyetimin se duke u bazuar në marrëveshjen e Partneritetit Publik Privat për Operim dhe Zgjerim të A. N. të P. "A. J." të nënshkruar mes Republikës së Kosovës dhe L. K. I. A. J.S.C. të datës 12 gusht 2010, e drejta ekskluzive për zhvillimin dhe mirëmbajtjen, financimin dhe operimin e A.N. të P. "A. J." është transferuar tek L. K. I. Airport J.S.C. Pretendimet e paditësit se e paditura nuk i ka përfillur procedurat në bazë të Ligjit të Punës dhe Kontratës së punës nuk qëndrojnë. Baza ligjore në të cilën thirret paditësi në kërkesëpadinë e tij nuk ka të bëjë me këtë kontest pune. E paditura, L. K. I.A. J.S.C, "A. J.", vendimin për mos ripërtërjetjen e kontratës së punës e ka bërë në bazë të fuqisë ligjore, përkatësisht në nenin 67 par. 1.3 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 dhe në kontratën e punës. Njoftimi prej 30 ditëve kalendarike i lëshuar paditësit nga e paditura për mos-ripërtërjetjen e kontratës së punës është i bazuar në dispozitat e Ligjit të Punës, në nenin 71, paragrafi 2, dhe nenin 67, paragrafi 1.3 të Ligjit të Punës si edhe në nenin 1.1 të Kontratës së Punës, dhe në bazë të këtyre dispozitave paditësit nuk i është ripërtërjetje kontrata e punës. Sipas këtyre dispozitave të Ligjit të Punës (neni 67 paragrafi 1.3 si dhe neni 71 paragrafi 2) punëdhënësi nuk ka obligim të ripërtërijë kontratat e punës në kohë të caktuar pas skadimit të tyre (pa marrë parasysh përformancën) dhe ka vetëm obligim që të respektojë afatin e njoftimit prej 30 ditësh. Këtë qëndrim e kanë mbajtur dhe Gjykatat e Kosovës në kontestet e punës lidhur me kontratat e punës me afat të caktuar dhe pretendimet e kundërta do të krijonin precedent të rrezikshëm në praktikën gjyqësore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.464/20 i datës 27.05.2021, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: gjykata vlerëson se e paditura me rastin e shkëputjes të kontratës së punës paditësit me vendimin e datës 31.01.2020, nuk i ka respektuar dispozitat ligjore të parapara me Ligjin e Punës dhe Marrëveshjen Kolektive, si dhe të njëjtat vendime janë marr në kundërshtim me këtë Ligj. Kjo për faktin se mbi bazën e të gjitha provave të administruara si më lartë, të cilave gjykata ia fali besimin në

tërësi, u vërtetua se paditësi tek e paditura ka themeluar marrëdhënie pune për periudhë të caktuar dhe atë mbi bazën e kontratës së punës të datës 05.07.2019 në vendin e punës si "Terminal Building Cleaning", me pagën bruto mujore prej 215.79€, duke iu vazhduar kontrata e punës me amendamentet e saj deri më datë 31.01.2020. Paditësi ishte pjesëmarrës i grevës së datës 19.20 dhe 21.08.2019, të organizuar nga Shoqata Sindikale e Pavarur e të paditurës, paditësit asnjëherë nuk i është dhënë performancë e pakënaqshme për kryerjen e detyrave të punës për të cilat është caktuar, u vërtetua se e paditura nga periudha e mbajtjes së grevave të punëtorëve nga data 21.08.2019 deri më datë 03.04.2020, kur paditësit nuk i është vazhduar kontrata e punës, ka punësuar 4 punëtor të ri në pozitën "Terminal Building Cleaning", u vërtetua se vendi i punës së paditësit është i karakterit të përhershëm, dhe e paditura përkundër marrëveshjes së arritur në takimin e mbajtur më datë 23.08.2019, në mes të SH.S.P (Shoqatës Sindikale të Punëtorëve) ANP "A. J." dhe Menagimentit të të paditurës, në pikën 6 të kësaj Marrëveshje palët u dakorduan se punëdhënësi të ndalojë dhe të mos ndërmerr masa ndaj punëtorëve grevist, se nuk do të zhvillojë procedurë disiplinore kundër punëtorëve të cilët gjatë grevës kanë bërë veprime të papërshtatshme, andaj e paditura pa zhvilluar procedurë të brendshme për ndonjë cenim të detyrave të punës nga paditësi, me vendim me shkrim të datës 31.01.2020, e ka njoftuar paditësin se nuk do ti vazhdohet kontrata e punës që nga data 31.01.2020, ndaj të cilit vendim paditësi në afatin ligjor ka parashtruar ankesë tek e paditura më datë 07.02.2020, ankesë kjo e cila është refuzuar si e pabazuar nga e paditura me përgjigjen në ankesë të datës 20.02.2020, dhe vendimi i të paditurës i datës 31.01.2020 është vërtetuar si i drejtë, dhe më pas paditësi në afatin ligjor ka ushtruar padi pranë kësaj gjykate në procedurë kontestimore për mbrojtjen e të drejtave të tij të cilat rrjedhin nga marrëdhënia e punës. Gjykata erdhi në përfundim se vendimi i të paditurës për mos ripërtëritjen e kontratës së punës është i kundërligjshëm, dhe atë i njëjti si i tillë është marrë në kundërshtim me dispozitat e nenit 4 të LMD-së, kjo për faktin se edhe pse vendi i punës së paditësit ku ka punuar tek e paditura që nga fillimi i kontratës së parë të punës së datës 05.07.2019 dhe një amendamenti të kontratës së datës 27.12.2019 ku paditësi ka punuar pandërprerë, ka qenë vend pune i përhershëm, e paditura si punëdhënëse ka lidhur kontratë pune në kohë të caktuar, që nga data 05.07.2019, deri më datë 11.10.2019, dhe në mënyrë të pandërprerë me 2 amendamente të saj, kjo kontratë i është vazhduar deri më datë 31.01.2020, dhe deri në atë kohë vendi i punës ku ka punuar paditësi ka qenë vend pune i përhershëm, ashtu që me kontrata të tilla të njëpasnjëshme të lëshuara për kohë të caktuar, është cenuar parimi i ndërgjeshmërisë dhe ndershmërisë, kështu duke u mbajtur paditësi në gjendje të pasigurt

juridike gjatë ekzistimit të marrëdhënies së punës që nga data 05.07.2019 e deri më datë 31.01.2020. Andaj gjykata vlerëson se punëmarrësi nuk mund të heq dorë nga të drejtat e punëtorëve që rrjedhin nga dispozitat urdhëruese nga neni 5.1 të Ligjit të Punës, ku përcaktohet se është i ndaluar çfarëdo diskriminimi në punësim, profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masa disiplinore, ndërprerja e kontratës së punës ose çështjeve tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe ligjet tjera në fuqi, dhe mbi këtë bazë e paditura ka dështuar për të vërtetuar faktin se i është përmbajtur ndalimit të diskriminimit. Me vendimin për mos ripërtëritjen e kontratës së punës është cenuar dispozita e nenit 13 të Ligjit për Greva, ngase e paditura qysh nga koha e mbajtjes së grevave të punëtorëve të të paditurës më datë 21.08.2019, ka mbajtur trajnime me punëtor të rijnë, dhe prej mbajtjes së grevave të punëtorëve e deri në kohën e mos ripërtëritjes së kontratës së punës paditësit, ka pranuar 66 punëtorë të rijnë, mandej po në këtë periudhë paditësit së bashku me 23 punëtorë të tjerë të punësuar tek e paditura nuk i është vazhduar kontrata e punës ndërsa tre të tjerëve i është ndërprerë kontrata e punës, fakt ky i cili vërtetohet se paditësit nuk i është vazhduar kontrata e punës vetëm se i njëjti ka qenë njëri prej pjesëmarrëseve në grevën e organizuar nga SH.S.P, më datë 19, 20 dhe 21.08.2019, përkundër marrëveshjes së arritur mes SH.S.P-së së Aeroportit dhe Menaxhmentit të punëdhënësit (këtu të paditurës), të arritur më datë 23.08.2019, se punëtorët grevist nuk do të kenë pasoja për shkak të pjesëmarrjes në këto greva. Gjykata vlerëson se e paditura me rastin e mos ripërtëritjes së kontratës së punës paditësit me vendimin e datës 31.01.2020 dhe përgjigjen në ankesë të datës 20.02.2020, nuk i ka respektuar dispozitat ligjore të parapara me Ligjin e Punës dhe Marrëveshjen Kolektive, si dhe të njëjtat vendime-përgjigje janë marrë në kundërshtim me këtë Ligj. Kjo u vërtetua nga vendimet e Inspektoratit të punës së shkallës së parë me nr. Rap 01-..., të datës. 02.04.2020, me të cilin janë anuluar vendimet për mos vazhdimin e kontratës së punës së punëtorëve të tjerë dhe paditësit, dhe vendimit të IP-së shkallës së dytë me nr. ..., të datës 06.08.2020 me të cilin vendim, ankesa e të paditurës është refuzuar si e pabazuar dhe vendimi i shkallës së parë të Inspektoratit të Punës është vërtetuar. Meqenëse është anuluar vendimi për mosripërtëritjen e kontratës së punës si jo ligjor, e bazuar në dispozitat e nenit 136.1,173 dhe 174 të LMD-së, si dhe nenit 80.1.1 të LP-së, gjykata vlerëson se paditësit i takon edhe shpërblimi i dëmit, për shkak të largimit të kundërligjshëm nga marrëdhënia e punës, lartësinë e të cilit dëmshpërblim gjykata e caktoi duke u bazuar në ekspertizën financiare dhe plotësimin e saj të hartuar me shkrim nga eksperti financiar A. I..., ekspertizë kësaj të cilës gjykata në tërësi ia fali besimin dhe e vlerësoi si ekspertizë të

hartuar në mënyrë profesionale dhe në bazë të rregullave të shkencës dhe të profesionit, andaj edhe e detyroi të paditurën, që përveç kthimit të paditësit në punë në pozitën e mëhershme dhe detyrat e punës së mëhershme të cilat i ka kryer para se t'i ndërpritet marrëdhënia e punës, të njëjtit t'ia shpërblejë dëmin material në shumën prej 2,384.50€ në emër të pagave të pa paguara, dhe atë me kamatë ligjore prej 8% vjetore që nga data e hartimit të ekspertizës financiare më datë 20.11.2020, e deri në pagesën definitive, si dhe në të ardhmen për çdo muaj në emër të pagës bruto shumën prej 303.20€, nga data 20.11.2020, e deri në kthimin e paditësit në punë dhe detyra të punës si më lartë, si dhe ta detyrojë të paditurën që në emër të kontributit pensional të punësuarit shumën prej 129.74€, si dhe shumën prej 81.95€, në emër të tatimit në burim, dhe në emër të kamatës së arritshme shumën prej 69.61€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim ashtu si në pikën. I të dispozitivit të aktgjykimi.

Gjykata e Apelit të Kosovës në procedurën e vendosjes sipas ankesës të paditurës, me aktgjykimin Ac.nr.9165/2021 të datës 15.12.2022, e ka aprovuar ankesën e palës së paditur dhe e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar me revizion, të përshkruar si më lartë.

Gjykata e Apelit në arsyet e saj ndër të tjera ka theksuar se, sipas dispozitës së nenit 80 par.1 pika 1 të Ligjit të Punës, e paditura ka obligim që paditësit t'ia paguaj pagat sipas kontratës së punës, ku nga shkresat e lëndës rezulton se, pagat e tilla për kohëzgjatjen e kësaj kontrate, e paditura ia ka paguar paditësit. Mirëpo, konstatimi i gjykatës së shkallës së parë, se qëndron obligimi i të paditurës që paditësit t'ia paguaj pagat sikurse në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, e deri në kthimin e tij në punë, është i pa qëndrueshëm, nga se paditësit i takojnë vetëm pagat, sikurse e paditura të mos ia kishte paguar për periudhën e kohëzgjatjes së kontratës së punës të paditësit, me të paditurën, e cila kontratë në këtë rast është në kohë të caktuar. Mirëpo një situatë të tillë, nuk e kemi në rastin konkret të paditësit, sepse kontrata e punës nuk është jo ligjore, por është në pajtim me nenin 67 par. 1 pika 1.3 të Ligjit të Punës, ku përcaktohet qartë situata e ndërprerjes së kontratës së punës sipas fuqisë ligjore, ku ndër të tjera, në pikën 1.3 të nenit në fjalë theksohet se marrëdhënia e punës ndërpritet sipas fuqisë ligjore me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës". Ashtu që, gjykimi përtej kësaj kohëzgjatje të kontratës, është i pa mbështetur në ligj. Në rastin e paditësit, gjykata e shkallës së parë e mbështetë vendimin e saj në dispozitat e nenit 80 par.1 pika 2 të Ligjit Nr. 03/L-212. Mirëpo, sipas Gjykatës së Apelit, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, nuk e ka arsyetuar e as administruar asnjë

provë, e cila dëshmon se, kemi të bëjmë me dispozitat e nenit 5 të ligjit të sipër cituar, ose që paraqet diskriminim, apo mbi çfarë baze është bërë diskriminimi i paditësit, në situatën konkrete, edhe pse në këtë rast kemi të bëjmë me ndërprerje të kontratës së punës sipas fuqisë ligjore, nga neni 67 par.1 pika 3 e Ligjit të Punës, nenit 6.1 respektivisht nenit 1 të Kontratës së punës, në lidhje me nenin 10 përkatësisht 11 par.1.11 të Ligjit të Punës. Gjykata e Apelit ka vlerësuar se nëse i referohemi Ligjit kundër Diskriminimit (Ligji Nr.2004/3) atëherë “Diskriminimi i drejtpërdrejtë nënkuptohet kur një person trajtohet, është trajtuar, ose do të trajtohet në mënyrë të pa barabartë, në krahasim me tjetrin, duke u bazuar në një apo më shumë nga bazat e nenit 2 të këtij ligji si: gjini, moshë, gjendje martesore, gjuhë, paaftësi fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religjionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale, racës, pronës, lindjes ose staturave tjera”. Prandaj është i pa qëndrueshëm dhe njëkohësisht të pa bazuar qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë, kur i referohet dispozitës së nenit 80 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03/L-2012), lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës përkatësisht mos ripërtëritjen e marrëdhënies së punës të paditësit, në rastin konkret, sepse *kontrata e punës me paditësin, ka qenë në kohë të caktuar*. Sipas Gjykatës së Apelit, në rrethana të tilla, kur kontrata e punës si instrument i realizimit të marrëdhënies së punës ka skaduar, kthimi i paditësit në punë është bërë i pa realizueshëm, për faktin se ka skaduar kontrata e punës. Paditësit i është ndërprerë kontrata e punës, me vendimin e të paditurës të datës 31.01.2020, ashtu që periudha përtej asaj që vetë palët kontraktuese e kanë përkufizuar, nuk duhet llogaritur paditësit të ardhurat personale, e as kompensimet tjera shtesë, siç gabimisht ka vendosur gjykata e shkallës së parë në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, sepse paditësi nuk ka pas kontratë të punës dhe nuk ka marrë pjesë në realizimin e tyre, pas datës 31.01.2020 kur kontrata e punës veç ka skaduar. Prandaj, sipas Gjykatës së Apelit bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar, tashmë edhe nga gjykata e shkallës së parë, rezulton se paditësi ka pasur kontratë të punës në kohë të caktuar, e cila në fakt i është vazhduar disa herë, por edhe përkundër këtyre vazhdimeve, e gjithë përvoja e punës e paditësit, nuk i kalon 10 vite, ashtu siç kërkohet me dispozitat e nenit 10 par.5 të Ligjit të Punës, ku në mënyrë eksplicite parashihet se, ” *Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pa caktuar kohore*”. Mirëpo, një situatë të tillë nuk e kemi në rastin e paditësit, i cili sipas shkresave të kësaj lënde nuk ka pasur akoma dy vite përvojë të punës, në kohën e inicimit të këtij kontesti.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që i njëjti aktgjykim nuk është i përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore (LPK-së), sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së dytë është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së dytë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për pathemelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, për arsye se:

Me nenin 10 Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: 1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuar. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji. 2. Kontrata e Punës mund të lidhet për: 2.1. një periudhë të pacaktuar; 2.2. një periudhë të caktuar; dhe 2.3. për punë dhe detyra specifike. 3. Kontrata e punës që nuk përmban kurrfarë hollësish për kohëzgjatjen e vet, duhet të konsiderohet si kontratë në periudhë të pacaktuar. 4. Kontrata për periudhë të caktuar nuk mund të lidhet për një periudhë më të gjatë se dhjetë (10) vite. 5. Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore. 6. Kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindnjëzet (120) ditë brenda një (1) viti. 7. Personi që ka lidhur kontratë të punës për një afat të caktuar ose për një detyrë specifike, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parapara me këtë ligj, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj.

Me nenin 11 paragrafi 1 nga pika 1.1) deri në pikën 1.13), të këtij ligji është përcaktuar se çka duhet të përmbaj kontrata e punës.

Me nenin 67 paragraf 1 pika 1.3, të këtij ligji, përcaktohet se: Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet: ... me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës;... .

Me nenin 71 paragrafi 2 i këtij ligji, përcaktohet se: Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës për kohë të caktuar me njoftim prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike. Punëdhënësi i cili nuk ka për qëllim të ripërtërijë kontratën me periudhë të caktuar duhet të informojë të punësuarin së paku tridhjetë (30) ditë para skadimit të kontratës. Dështimi për ta njoftuar nga punëdhënësi, do t'i japë të drejtën të punësuarit për zgjatjen e tridhjetë (30) ditëve kalendarike shtesë me pagë të plotë.

Nga interpretimi i dispozitave ligjore të Ligjit të Punës dhe dispozitave të kontratës së punës të datës 05.07.2019, amendamentin e kontratës së punës të datës 16.10.2019, amendamentin e kontratës së punës të datës 27.12.2019, si dhe nga shqyrtimi i të gjitha provave dhe shkresave të lëndës edhe Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar. Në këtë kuptim gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të drejtë ka konstatuar dhe ka vendosur që kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se paditësi dhe e paditura raportin e tyre - të drejtat dhe detyrat e tyre, punëdhënës - punëmarrës i kanë rregulluar me kontratë në formë të shkruar, duke përcaktuar saktë të drejtat dhe detyrat e tyre reciproke. Gjykata ka konstatuar se kontratat e punës janë lidhur në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të cekura më lartë, se kushtet e kontratave të punës të lidhura në mes të paditësit dhe të paditurit duke marrë për bazë kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës, si dhe përfundimin e marrëdhënies së punës, siç ka ndodhur në këtë rast janë në pajtim të plotë me dispozita ligjore të Ligjit të Punës dhe dispozitat e kontratës së punës. Në këtë rast i padituri me vendim e ka njoftuar paditësin për mos ripërtëritjen e kontratës së punës, për shkak të skadimit të kontratës edhe pse nuk ka pasur detyrim ta bëjë një gjë të tillë në kuptim të dispozitave ligjore të lartë cekura.

Gjykata Supreme e Kosovës, e vlerësoi të pabazuar edhe pretendimin e paditësit se kërkesa e tij është e bazuar në bazë të nenit 10 paragrafi 5 të Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, me të cilin përcaktohet se: “ Kontrata e Punës, për një periudhë të caktuar, që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme, për një periudhë të punësimit më të gjatë se tri (3)vite, do të konsiderohet si kontratë e lidhur në kohë të pacaktuar ”, për arsye se: Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e lidhur më datë 18.03.2014, e lidhur dhe nënshkruar nga Organizatat e punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të

Kosovës), si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015. Nga kjo rezulton se edhe sikur të zbatohet neni 10 paragrafi 5 i kësaj marrëveshje, nga momenti kur paditësi ka themeluar marrëdhënie të punës, për kohë të caktuar, për herë të parë më datë 05.07.2019, e deri sa ka qenë në fuqi kjo marrëveshje nuk i ka pasur tri vite të punës, te e paditura, ndonëse në momentin e largimit të paditësit nga puna nuk ka pasur një Kontratë Kolektive në fuqi, dhe të aplikueshme në rastin konkret, çka do të thotë se kërkesëpadia e paditësit është pabazuar.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga paditësi nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragrafi 2, të LPK-së, përcaktohet se: “Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike”.

Gjykata Supreme me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.102/2023, datë 29.03.2023

Kryetar i kolegjit
Fejzullah Rexhepi